



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.54/2016

Prishtinë, më 21.4.2016, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviç, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Blerim Grainca, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Besim Beqaj, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Remzije Hajdari, MTI; Ardi Shita, USAID; Fazlie Bekteshi, Nezir Myrtaj dhe Skënder Xani, MZHE; Ali Hamiti, ekspert; Lumniye Murati, ZPRK; Afrim Ajvazi, ZRRE; Dardan Abazi, INDEP; Sanije Berisha, OSB; Fjolla Uka, KDI; Evlina Kabashi dhe Mjellma Kadriu, praktikante të Komisionit.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.05/L-081 për Energjinë;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.05/L-083 për falimentimin;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit, z. Muhamet Mustafa, propozoi që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin për investimet strategjike, me arsyetimin se në mbledhje e fundit, si komision, kemi shkuar me dy propozime për një nen, ndërkohë që drejtorja ligjore e Kuvendit na ka këshilluar që nuk mund të jetë një formë e tillë, si dhe janë disa gabime në amendamente tjera, që duhet t'i diskutojmë dhe t'i miratojmë.

Fatmir Rexhepi, propozoi që pika 4 (e katërt) e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-083 për falimentimin, të kalojë në pikën e dytë të rendit të ditës, sepse s'kemi shumë dilema dhe mund ta kalojmë më shpejt.

Komisionin u pajtua me këto propozime.

2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Kryetari, tha se siç iu njoftova, duhet ta përkrahim vetëm amendamentin 32 të Komisionit, ku ndryshohet neni 22, ndërsa propozimin shtesë që e dha ministria, duhet ta shikojë mundësinë që ta propozojë në faza tjera. Po ashtu, tha se amendamentin 16, duhet ta ndajmë dhe ta bëjmë edhe një amendament të ri 17, sepse gjatë përpilimit të amendamentit, është parë se nuk ka kuptim të mbetet njëjtë, ku thuhet: "Komisioni ndërministror i dërgon raporte Komisionit ndërministror", andaj neni 8, nënparagrafi 1.7, fshihet.

Komisioni përkrahu propozimet e kryetarit.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës.

2. Raporti t'iu procedohet komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-083 për falimentimin

Kryetari, tha se Projektligjin për falimentimin, e kanë punuar ekspertët ndërkombëtarë dhe grupi punues e ka shqyrtuar dhe i ka hartuar amendamentet, ku janë precizuar në detaje sesi rregullohet çështja e falimentimit. Po ashtu, tha se këtë grup pune e ka udhëhequr, z. Fatmir Rexhepi, në mungesë të kryesuesit, z. Besim Beqaj. Pastaj, kryetari,

në mungesë të kryesuesit të grupit punues, e prezantoi secilin amendament veç e veç dhe e hodhi në diskutim dhe votim, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1, nënparagrafi 2.5, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 1, paragrafi 3, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 2, paragrafi 1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 4

Neni 2, pas nënparagrafit 2.4, shtohet një paragrafi i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5

Neni 2, pas nënparagrafit 2.5, shtohet një nënparagraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6

Neni 3, paragrafi 1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 7

Neni 3, në tërë tekstin e këtij neni, fshihet fjala “nënkupton”, që fillon pas termit përkufizues.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 8

Neni 3, shtohet një paragraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 9

Neni 4, pas paragrafit 2.4, shtohen dy paragrafë të rinj.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 10

Neni 6, pas nënparagrafit 2.6, shtohet një nënparagraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 11

Neni 8, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 12

Pas neni 8, shtohet një nen i ri.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 13

Titulli i kapitullit II, fjala “NDËRMARRJET”, zëvendësohet me “NDËRMARRJEVE”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 14

Neni 10, fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 15

Neni 11, riformohet.

Kryetari kërkoi sqarim për këtë amendament, sa i përket përcaktimit të NVM-ve.

Ardi Shita, ekspert nga USAID-i, sqaroi se qëllimi ka qenë të definohen, ndërmarrje e vogël dhe e mesme, në mënyre më precize për nga qarkullimi vjetor dhe për nga numri i të punësuarve në ndërmarrjet e mëdha dhe kjo është bërë nga praktika e Bashkimit Evropian.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 16

Neni 14, paragrafi 1, pas referencës “Kapitulli VI”, shtohen fjalët: “të këtij ligji” dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit, kur shfaqet një rast i njëjtë.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 17

Neni 14, nënparagrafi 1.4.1, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 17

Neni 16, fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 18

Neni 17, pas referencës “neni 18”, shtohen fjalët: “të këtij ligji” dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit, kur shfaqet një rast i njëjtë.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 19

Neni 32, i ndryshohet titulli, si vijon: “Paraqitja e informatave”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 20

Neni 34, fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 21

Neni 44, riformohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 22

Neni 45, paragrafi 1, referenca “paragrafit 2”, zëvendësohet me “nënparagrafin 1.2”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 23

Neni 46, paragrafi 2, pas referencës “paragrafit 1 të këtij neni.”, shtohet “nga”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 24

Neni 50, nënparagrafi 3.2, fjala “bilancit”, zëvendësohet me “bilanci”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 25

Neni 51, nënparagrafi 3.3, fjala “otojë”, zëvendësohet me “votoj”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 26

Neni 52, paragrafi 4, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 27

Neni 59, numrat e nënparagrafëve, korrigjohen në bazë të renditjes.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 28

Neni 59, nënparagrafi 2.5, bëhet paragraf 3 i këtij neni.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 29

Neni 60, paragrafi 3, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 30

Neni 64, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 31

Neni 68, nënparagrafi 1.3, fjala “shkarimin”, zëvendësohet me “shkarkimin”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 32

Neni 68, në fund të nënparagrafit 3.1, shtohet lidhëza “ose”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 33

Neni 69, titulli i nenit riformulohet si vijon: “Komiteti i kreditorëve në rastin e riorganizimit”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 34

Neni 69, nënparagrafi 3.2, fjala “kfizimeve”, zëvendësohet me fjalën “kufizimeve”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 35

Neni 69, nënparagrafi 3.4, fjala “interpelancë”, zëvendësohet me “seancë”, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 36

Neni 69, nënparagrafi 3.7, shifra “mnd”, zëvendësohet me fjalën “mund”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 37

Neni 77, nënparagrafi 1.4, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 38

Neni 78, nënparagrafi 1.7, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 39

Neni 80, i ndryshohet titulli.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 40

Neni 83, nënparagrafi 4.1.1, bëhet paragraf 4.2.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 41

Neni 88, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 42

Neni 88, nënparagrafi 2.1, referenca “nenin 89”, ndryshohet në “nenin 88”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 43

Neni 91, nënparagrafi 2.2, fshihet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 44

Neni 91, paragrafi 4, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 45

Neni 92, në nënparagrafin 3.1, shifra “[25]”, zëvendësohet me “njëzet e pesë (25)”, ky ndryshim teknik i kësaj natyre vlen për këtë nen, si dhe në tërë tekstin e ligjit.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 46

Nenit 93, i ndryshohet titulli si vijon: “Komiteti i kreditorëve me rastin e likuidimit”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 47

Neni 96, nënparagrafi 1.2, fjalët “shoqërisë aksionare”, zëvendësohen me “shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 48

Pas nenit 101, shtohet një nen i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 49

Neni 108, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 50

Neni 109, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 51

Neni 113, paragrafi 2, fshihet fjala “etj.”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 52

Neni 115, fshihet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 53

Neni 128, paragrafi 1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 54

Neni 129, nënparagrafi 1.3, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 55

Neni 129, nënparagrafi 2.2, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 56

Neni 133, paragrafi 3, fjalët: “sigurohet masa”, zëvendësohen me fjalët: “sigurohet se masa”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 57

Pas nenit 144, shtohet një nen i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 58

Neni 145, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-083 për falimentimin.*
- 2. Raporti t’iu procedohet komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës.*

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-081 për Energjinë

Kryetari, tha se për Projektligjin për Energjinë, grupi i punës ka angazhuar ekspertin, profesor Ali Hamitin dhe e ka shqyrtuar, analizuar dhe i ka hartuar amendamentet, ku janë precizuar mirë, deri në detaj dhe janë nxjerrë gjithsej 66 amendamente.

Raif Qela, tha se grupi punues, gjatë gjithë kohës, ka punuar me përkushtim të madh në Projektligjin për Energjinë. Z. Qela, theksoi se projektligji është hartuar pikërisht, që duhet të afrohet me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Pra, në të gjitha amendamentet që janë nxjerrë, janë dhënë përkufizimet se çka rregullojnë, deri në detaje, fushën e energjisë.

Sala Berisha- Shala, kërkoi sqarim, pasi që projektligji për Energjinë, ka 37 nene dhe kanë dalë 66 amendamente. Propozoi që mos të bëhen amendamente për çdo problem teknik.

Kryetari propozoi që, këto probleme teknike dhe gjuhësore, le të rregullohen nga Drejtoria për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim Ligjor. Pastaj, e prezantoi secilin amendament veç e veç dhe i hodhi në diskutim dhe votim, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 1, fjala “ripërtërishme”, zëvendësohet me “ripërtërishme” dhe ky ndryshim vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 2, nënparagrafi 2.1, termi: “Strategjisë së Energjisë”, zëvendësohet me “Strategjisë së energjisë (në tekstin e mëtejme: Strategjia);”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 2, nënparagrafi 2.2, shprehja “Qeverisë së Kosovës”, zëvendësohet me “Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria)” dhe ky ndryshim vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 4

Neni 2, nënparagrafi 2.3, fjalia: “Zyra e Rregullatorit për Energji”, zëvendësohet me “Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: “Rregullatori”).

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5

Neni 3, paragrafi 1 dhe 2, fjala “Shprehjet”, zëvendësohet me “Termet”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6

Neni 3, nënparagrafi 1.1, termi “Aktivitetet energjetike”, zëvendësohet me “Aktivitete të energjisë”. Neni 3, në tërë tekstin e këtij neni, termet renditen sipas alfabetit. Në tërë tekstin e këtij neni, çdo term i shpjeguar (Aktivitetet energjetike, Bashkëprodhim, Bilanci i Energjisë etj.), shënohet në trajtën e pashquar (Aktivitete energjetike, Bashkëprodhim, Bilanci i energjisë etj.). Në tërë tekstin e këtij neni, fshihet fjala “nënkupton”, si fillim i shpjegimit të termit, ndërsa teksti më tutje vazhdon i përshtatur. Po ashtu, fjalët “transmisionit” e “transmisionin”, zëvendësohen me “transmetimit” e “transmetimin”, përkatësisht, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 7

Neni 3, nënparagrafi 1.5, fjala “valore”, zëvendësohet me “e valëve”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 8

1.6 Energji nga burime të ripërtëritshme – energjia nga burime të ripërtëritshme jofosile, siç janë energjia nga uji, era, dielli, deti, biomasa, energjia aerotermike, energjia gjeotermike, energjia nga gazrat e deponive, nga gazrat nga stabilimentet e trajtimit të ujërave të zeza dhe nga biogazi;

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 9

Neni 3, nënparagrafi 1.11, fjala “proporcionin”, zëvendësohet me “raporti”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 10

Neni 3, nënparagrafi 1.12, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 11

Neni 3, nënparagrafi 1.13, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 12

Neni 3, nënparagrafi 1.15, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 13

Neni 3, pas nënparagrafit 1.15, shtohen edhe tre nënparagrafë të rinj.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 14

Neni 3, nën paragrafi 1.17, fjala “kombëtare”, zëvendësohet me “shtetërore” dhe kjo vlen për krejt tekstin e ligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 15

Neni 3, nënparagrafi 1.20, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 16

Neni 3, nënparagrafi 1.21, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 17

Neni 3, nënparagrafi 1.22, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 18

Neni 3, nënparagrafi 1.23, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 19

Neni 3, pas nënparagrafit 1.23, shtohet edhe një nënparagraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 20

Neni 3, nënparagrafi 1.24, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 21

Neni 3, pas nënparagrafit 1.24, shtohet edhe një nënparagraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 22

Neni 3, nënparagrafi 1.28, fjala “final”, zëvendësohet me “fundor”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 23

Neni 3, paragrafi 1.29, fjala “afatgjate”, zëvendësohet me “afatgjatë”, përkatësisht “afatgjata”, varësisht se a lidhet me emër në numrin njëjës apo në shumës, dhe ky ndryshim vlen për tërë tekstin e projektligjit.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 24

Neni 3, pas nënparagrafit 1.29, shtohen edhe tre nënparagrafë të rinj.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 25

Neni 3, nënparagrafi 1.34, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 26

Neni 3, pas nënparagrafit 1.35, shtohen edhe dy nënparagrafë të rinj.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 27

Neni 3, nënparagrafi 1.36, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 28 Neni 3, nënparagrafi 1.38, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 29

Neni 3, nënparagrafi 1.40, në rreshtin e gjashtë në mes, te fjalët “ose shpërndarjes” zëvendësohet me “ose të shpërndarjes”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 30

Neni 3, nënparagrafi 1.44, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 31

Neni 3, nënparagrafi 1.45, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 32

Neni 3, pas nënparagrafit 1.45, shtohen edhe dy nënparagrafë të rinj.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 33

Neni 3, nënparagrafi 1.46, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 34

Neni 3, shtohet një përkufizim i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 35

Neni 5, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 36

Në nenin 6, paragrafi 5 i këtij ligji, emri “vit”, në numrin shumës bëhet “vjet”, e jo “vite”. Po ashtu, edhe në krejt tekstin e këtij ligji, kjo fjalë të zëvendësohet në lakimet përkatëse (jo “viteve”, por “vjetëve” (derisa janë të përcaktuar: 3, 10, 99 etj.), kurse teksti në vazhdim t’i përshtatet shumësit të gjinisë mashkullore të emrit “vit”, m. sh. “vjet”, “vjetët”, “vjetëve” a “vjetësh”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 37

Neni 6, nënparagrafi 7, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 38

Neni 6, nënparagrafi 7.12, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 39

Neni 8, paragrafi 4, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 40

Neni 8, paragrafi 5, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 41

Neni 8, paragrafi 6, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 42

Neni 8, paragrafi 10 (pa nënparagrafët), riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 43

Neni 8, paragrafi 12, fjala “mandator” zëvendësohet me “e detyrueshëm”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 44

Neni 8, nënparagrafi 12.1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 45

Neni 10, paragrafi 11, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 46

Neni 11, paragrafi 2, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 47

Neni 14, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 48

Neni 15, paragrafi 1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 49

Neni 16, paragrafi 2 riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 50

Neni 17, paragrafi 2, në fund të paragrafit, pas fjalës “fuqi”, shtohet shprehja “në Kosovë”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 51

Neni 17, paragrafi 3, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 52

Neni 18, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 53

Neni 23, paragrafi 1, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 54

Neni 25, nën paragrafi 1.5, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 55

Neni 25, paragrafi 2, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 56

Neni 26, paragrafi 1, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 57

Neni 27, nënparagrafi 2.3, fjala “patundshme”, zëvendësohet me “paluajtshme”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 58

Neni 27, nënparagrafi 2.4, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 59

Neni 27, nënparagrafi 2.5, fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 60

Neni 27, paragrafi 9, fjalia: “Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës”, zëvendësohet me “gjykatën kompetente të Republikës së Kosovës”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 61

Neni 29, paragrafi 2, fjala “rrjetat”, zëvendësohet me fjalën “rrjetet”, kurse fjala “rrjetave”, zëvendësohet me fjalën “rrjeteve”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 62

Neni 32, paragrafi 2, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 63

Neni 33, paragrafi 3, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 64

Neni 33, paragrafi 5, në fund të paragrafit, pas fjalëve: “Inspektoratit të Energjisë:” , shtohet fjala “të cilët”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 65

Neni 33, paragrafi 6, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 66

Neni 33, paragrafi 7, në fund të paragrafit, pas fjalëve “mund të:”, shtohen fjalët “ndërmarrë këto veprime:”, kurse nënparagrafët vazhdojnë të përshtatur në mënyrën lidhore (të nxjerrë..., t’i propozojë..., ta dërgojë..., ta informojë...).

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 67

Neni 35, paragrafi 2, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamentet e Projektligjit nr. 05/L-081 për Energjinë.

2. Raporti t’iu procedohet komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë

Kryetari, theksoi se, po ashtu, edhe për Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë, grupi i punues, së bashku me ekspertin, e ka shqyrtuar, analizuar dhe i ka hartuar gjithsej 45 amendamente.

Raif Qela, tha se shumica janë rregullime teknike, gjuhësore dhe sintaksore, andaj këto amendamente e bëjnë Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë, më të kompletuar dhe të qartësuar për zbatim në praktikë.

Kryetari, pastaj e prezantoi secilin amendament, veç e veç dhe hodhi në diskutim dhe votim, si vijon :

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 1, fjala “transmision”, zëvendësohet me “transmetim” dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 1, paragrafi 2, fjala “bartjes”, zëvendësohet me “transmetimit”, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit, kur bëhet fjalë për gazin natyror; fjala “ripërtërishme”, zëvendësohet me fjalën “ripërtëritshme” dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 2, paragrafi 1, fjala “specifikisht”, zëvendësohet me shprehjen “në mënyrë specifike”; neni 2, paragrafi 3, fjala (folja) “kyç”, zëvendësohet me fjalën (foljen) “lidh”, në zgjedhimin e duhur; emri “kyçe” zëvendësohet me emrin “lidhje”, në lakimin e duhur dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 4

Neni 2, paragrafët 2 dhe 3, fshihen.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5

Neni 3, në tërë tekstin e këtij neni, fjala “Shprehjet”, zëvendësohet me fjalën “Termet”; në tërë tekstin e këtij neni termet e shpjeguar renditen sipas alfabetit; në tërë tekstin e këtij neni çdo term i shpjeguar (Bordi, Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë, Bashkëprodhimi etj.) shënohet në trajtën e pashquar (Bord, Bord i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë, Bashkëprodhim etj.); në tërë tekstin e këtij neni fshihet fjala “nënkupton”, si fillim i shpjegimit të termit, ndërsa teksti më tutje vazhdon i përshtatur.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6

Neni 3, nënparagrafi 1.5, fjala “simultan”, zëvendësohet me “i njëkohshëm”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 7

Neni 3, nënparagrafi 1.14, riformulohet, si dhe e riformuloi amendamentin e propozuar nga Grupi Parlamentar 6+, si vijon: “Për objektet që shërbejnë për qëllime fetare aplikohen tarifat e konsumatorëve familjarë;”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 8

Neni 3, nënparagrafi 1.15, shprehja “Konsumator i cenueshëm”, zëvendësohet me “Konsumator në nevojë”, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit. Në këtë paragraf, nyja “një”, fshihet dhe fjala “amvisëror”, zëvendësohet me “familjar”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 9

Neni 3, nënparagrafi 1.16, shprehja “Konsumator joshtëpiak”, zëvendësohet me “Konsumator jofamiljar”, kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 10

Neni 3, nënparagrafi 1.21, fjala “elektrike”, fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 11

Neni 3, pas nënparagrafit 1.21, shtohet një nën paragraf i ri.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 12

Neni 3, nënparagrafi 1.22, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 13

Neni 4, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 14

Neni 5, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 14 / nga GP 6+

Amendamenti nuk u përkrah nga Komisioni, sepse tha se janë mjaft 5 anëtarë të Bordit dhe nuk ka nevojë të jenë 7.

Amendamenti 15

Neni 6, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 16

Neni 7, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 17

Neni 8, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 18

Neni 10, teksti i paragrafit 1, pa nënparagrafë, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendament 19

Neni 10, pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 20

Neni 14, paragrafi 1, fjala “të njëjtit”, zëvendësohet me “tregut”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 21

Neni 15, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 22

Neni 16, nënparagrafi 3.5, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 23

Neni 17, paragrafi 2, fjalët “e ankesave për”, zëvendësohen me lidhëzën “dhe”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 24

Neni 21, paragrafi 1, fshihet shprehja “qëllimet vijuese”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 25

Neni 22, paragrafi 4, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 26

Neni 22, në nënparagrafët 5.2 deri 5.4, fshihet emërtimi: “Zyrës së Rregullatorit për Energji”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 27

Neni 22, paragrafi 7, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 28

Neni 23, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 29

Neni 25, paragrafi 5, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 30

Neni 25, paragrafi 7, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 31

Neni 26, paragrafi 3, emërtimi “Ligjit për Procedurën Administrative”, zëvendësohet me “Ligjit për Konfliktin Administrativ”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 32

Neni 26, paragrafi 6, pas fjalës “ndërmarrje”, shtohet fjala “publike a”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 33

Neni 27, nënparagrafi 2.3, afati “katërmbëdhjetë (14) ditësh”, zëvendësohet me “pesëmbëdhjetë (15) ditësh”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 34

Neni 28, paragrafi 2, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 35

Neni 34, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 36

Neni 40, paragrafi 4, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 37

Neni 40, paragrafi 7, pas tekstit “në paragrafin 4” shtohet teksti “të këtij neni”, dhe fshihet “do ta”, në përdorimin e parë në këtë paragraf.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 38

Neni 43, paragrafi 1, pas referencës “nenit 44”, shtohet teksti “të këtij ligji”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 39

Neni 43, paragrafi 5, në fjalinë e parë, fshihet fjala “për refuzim”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 40

Neni 46, nënparagrafi 1.3, fjala “tejkufitare”, zëvendësohet me “ndërkufitare”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 41

Neni 47, paragrafi 1, fshihet teksti “një apo më shumë”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 42

Neni 49 ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 43

Neni 50, paragrafi 1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 44

Neni 51, paragrafi 1, shprehja “ndërmarrje energjetike”, zëvendësohet me “ndërmarrje të energjisë”, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 45

Neni 57, paragrafi 8, fshihet teksti: “për realizimin e gjobës si borxh civil”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamentet e Projektligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë.

2. Raporti t’iu procedohet komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës.

6. Të ndryshme **Çështjet vijuese**

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa